

FTESE PER OFERTE

Në kuadër të projektit “Monitorimi i Kuvendit dhe veprimtarisë parlamentare 2021-2023”

ISP do të implementojë me mbështetjen e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim projektin “Monitorimi i Kuvendit dhe veprimtarisë parlamentare 2021-2023” me të cilën ISP ka nënshkruar një kontratë granti. Ky projekt synon, Monitorimin e Kuvendit për të mundësuar transparencë dhe llogaridhënie përmes vlerësimit të programit të transparencës në Kuvend dhe efikasitetit të veprimtarisë së deputetëve dhe grupeve parlamentare në lidhje me detyrimet kushtetuese, aktet rregullatore ligjore dhe të brendshme parlamentare.

Qëllimi kryesor është ndikimi pozitiv në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe aktivitetit përfaqësues të Kuvendit dhe deputetëve. Monitorimi aktiv i Kuvendit dhe aktiviteti i deputetëve është i favorshëm për krijimin e një sistemi të vlerësimit publik.

Për realizimin e aktiviteteve të planifikuara për projektin ISP shpall thirrjen publike për pjesëmarrje në tenderin për botimin e 3 raporteve mbi analizën e punës së parlamentit në formën e raporteve periodike pas çdo sesioni parlamentar .

Subjektet që konkurrojnë duhet të kenë eksperiencë në fushën e grafik - dizajnit, konceptimit të formatit, përgatitjes dhe printimit të materialeve shtypshkrime etj.

Ftohen subjekte të interesuara që përmbushin kriteret dhe kushtet e mëposhtme:

- Të jenë të regjistruara pranë QKB.
- Të ofrojnë shërbimin - Grafik dhe Dizajn, realizim, konceptim, përgatitje dhe printim.
- Të jenë fleksibël deri në variantin final dhe të ofrojnë garanci për dorëzimin e materialit brenda afatit dhe sipas specifikave teknike.
- Çmimi të përfshijë dhe TVSH -në.
- Fatura pranohet vetëm e fiskalizuar.
- Vendndodhja: Tiranë

Specifikimet teknike

1-Disenjim raporti Deri me 30,000 lekë /raport

2-Prodhim raporti: - Nr. faqeve - 50 faqe (+/- 10 faqe)
- Lloji -me ngjyra
- Pesha e letrës së brendëshme - 150-170 gr
- Kopertina-300 gr
- Formati A4
- Sasia 600 copë

Materiali i brendshëm do të realizohet në bashkëpunim me ISP.

Subjektet e interesuara të dërgojnë:

- Ofertë financiare (TVSH e përfshirë në çmim),
- Çertifikatën e regjistrimit në QKB si dhe
- Kopje materiale të prodhuar prej tyre ose të ofrojnë një link, ku të kenë publikuar punët e tyre.

Fondi limit për printimin e të tre raporteve në total 1,800,000 lekë (përfshirë tvsh-në) - 600 copë total (3 raporte*200 copë raporti).

Aplikimi duhet të dërgohen në një nga 3 variantet, jo më vonë se data 29/12/2021 ora 12:00:

- në formë elektronike në adresën e e-mailit contactaips@gmail.com,
- me postë në adresën: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë/ ose dorazi me zarf të mbyllur pranë zyrave të ISP me titullin e projektit sipër Monitorimi i Parlamenti prodhim raporti.

Të gjithë aplikuesit fitues apo jo fitues do të lajmërohen pas procedurës së përzgjedhjes, prandaj lutemi specifikoni qartë adresën e subjektit, e-mail ose një nr. kontakti.

Instituti i Studimeve Politike

Projekt i mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.

